



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA /
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY

Njësie Org.
Org. Jedin
Org Unit
Nr. i fagave
Broj stranica
No. pages

01/3 Nr. Prot.
Br. Prof.
Prof.No:
Dato:
Datum:
D.

1434 18.03.25

PRISHTEA A



N.H. V.P., "IBËR-LEPENC" SH.A.
D.D.

01-858 Dt. 18.03.2025
PRISHTINË-PRIŠTINA

NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Sheshi "Bil Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bil Klinton" Br.13 Priština, Kosovo
Tel: 038/526-070, 525-006, Fax: 038/526-159; Email: info@iber-lepenc.org

Raporti Vjetor për vitin 2024

Bordi i Drejtoreve në mbledhjen e 2-të të rregullt të mbajtur me datë 18.03.2025, pas shqyrtimit të raportit vjetor për vitin 2024 mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në NPH "Ibër-Lepenc" Sh.A mori vendim për aprovimin e këtij rapporti dhe kërkoi që i njëjti të përcillet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv:	Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve:
Nënshkrimi	Faruk MUJKA	Bajram MUSTAFA
Data: 18.03.2025		





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

Për: **BORDIN E DREJTORËVE TË N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**
Nga: **KRYESHEFI EKZEKUTIV N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**
Lënda: **RAPORTI VJETOR I PUNËS - 2024**
Data: **24.02.2025**

RAPORTI VJETOR I PUNËS – 2024 N.H."IBER-LEPENC"

Prishtinë, Shkurt

2025

Përmbajtja:

1. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të N.H “Ibër-Lepenc”	3
2. Raporti i punës së Kryeshefit Ekzekutiv	4
3. Raporti vjetor i punës për Vitin 2024 nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm.....	7
4. Departamenti „Uji dhe Gjenerimi ”.....	11
5. Departamenti „ Ujitja ”	16
6. Shërbimi i Financave	19
7. Prokurimi	24
8. Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta	29
9. Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim.....	31
10. Njësia Implementuese e WSCP	32
11. Aktivitetet tjera gjatë vitit 2024	34
11.1 Performanca Financiare gjatë viteve 2019-2024	34
11.2 Sulmi Terrorist në Varagë dhe veprimet e ndërmarra për sanimin emergjent dhe përfundimtar të dëmeve	37
11.3 Integrimi në bursën Alpex	40
11.4 Vizitat dhe bashkpunimet gjatë vitit 2024	41

1. Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv të N.H “Ibër-Lepenc”

Të nderuar anëtarë të Bordit, Ekzekutiv, bashkëpunëtorë, miq të nderuar.

Është një moment i rëndësishëm për të reflektuar mbi arritjet dhe punët e realizuara gjatë vitit që lamë pas. Vitin e kaluar, si ndërmarrje, kemi kaluar një periudhë të mbushur me sfida, por gjithashtu me shumë suksese dhe arritje të konsiderueshme, të cilat janë fryshtat e përpjekjeve të përbashkëta dhe angazhimit të secilit nga ne.

Në vitin 2024, si N.P.H “Ibër-Lepenc” Sh.A., arritëm të konsolidojmë disa nga objektivat tona kryesore, duke përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet që ofrojmë për qytetarët dhe komunitetet që ne shërbejmë. Angazhimi ynë për përmirësimin e menaxhimit të resurseve natyrore, të ujërave dhe të mjedisit ka dhënë rezultate pozitive, duke u pasqyruar në rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së shërbimeve që ofrojmë. Gjithashtu, kemi arritur të zgjerojmë mundësitë e bashkëpunimit me partnerë lokal dhe ndërkombëtarë, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin dhe mbështetje të projekteve të rëndësishme, që do t'i realizoj ndërmarrja jonë e të cilat do të reflektojnë në shërbime më cilësore për ndërmarrjet publike (KRU Prishtina dhe Mitrovica, KEK-u si dhe Ferronikeli), por edhe shërbime më të mira për bujqit dhe komunitetin .

Një tjetër arritje e rëndësishme në përbushjen e qëllimeve ishte rritja e kapaciteteve tona teknike dhe të menaxhimit të burimeve (liqeni i Ujmanit), duke mundësuar që të përballojmë më mirë kërkosat në rritje për shërbime dhe të përgjigjemi me fleksibilitet ndaj kushteve të ndryshueshme të mjedisit dhe tregut. Këto përpjekje na mundësuan të kemi një vit me performancë më të mirë dhe më të qëndrueshme.

Patjetër që arritja më e madhe mund të konsiderohet pjesëmarrja jonë në bursën e përbashkët Kosovë, Shqipëri për shitjen e energjisë elektrike, me çka krijojmë një bazë më të qëndrueshme të hyrave financiare në ndërmarrjen tonë.

Megjithatë, është e rëndësishme të pranojmë se, si çdo vit, kemi hasur gjithashtu disa sfida që kërkojnë reflektim dhe përmirësim të vazdueshëm. Të gjithë së bashku, kemi mësuar nga këto eksperiencia dhe kemi marrë mësimë që do të na ndihmojnë të përmirësojmë më tej shërbimet dhe menaxhimin tonë në vitin që kemi hyrë.

Ndër sfidat kryesore të vitit ka qenë thatësira e madhe , që ndikoi shumë në nivelin e ulët të ujit në liqenin e Ujmanit dhe sulmi terrorist në infrastrukturën tonë me datë 29 Nëntor, në fshatin Varage, komuna e Zubin Potokut.

Prioritetet tona për të ardhmen, gjithsesi mbeten të fokusuara në ofrimin e shërbimeve sa më kualitative, mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës ekzistuese, rehabilitimin dhe zgjerimin e kapaciteteve. Investimet kapitale në përputhje me politikat qeveritare për menaxhimin efikas të ujit , rritjen e të hyrave financiare, në këtë drejtim mund të shohim edhe vizitën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti dhe Ministres së Ekonomisë, znj Artane Rizvanollit, që është njëkohësisht vizita e parë e një Kryeministri në ndërmarrjen N.P.H “Ibër – Lepenc” Sh.A.

Përfundimisht, viti 2024 ishte një vit i rëndësishëm për N.P.H “Ibër-Lepenc”, dhe ne duhet të jemi krenar për gjithçka që kemi arritur. Sidoqoftë, ky është vetëm një prej hapave në rrugën e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe përmirësim të shërbimeve për komunitetin në përgjithësi.

2. Raporti i punës së Kryeshefit Ekzekutiv

2.1 Ngjarjet kryesore të vitit

Pos aktiviteteve të përditshme operacionale, gjatë këtyre muajve kemi pasur këto aktivitete si në vijim:

ARRITJET:

- Fillimisht duhet cekur se ndërmarrja ka përfunduar vitin 2024 me fitim operativ dhe fitim neto prej 1.8 mln €, që është me rëndësi të madhe për ekonominë e vendit tonë, duke e konsoliduar ndërmarrjen si një organizatë stabile e cila nuk varet nga donacionet apo subvencionet, por gjeneron të hyra të cilat, jo vetëm që i mbulojnë humbjet por edhe krijon hapësirë për investime vetanake kapitale.
- Drafti final i Raportit të Auditimit për vitin 2023 i cilësuar “i kualifikuar”. Gjetja kryesore nga 5 (pesë) në total është mungesa e rivlerësimit të aseteve të ndërmarrjes nga viti 2007. Realisht ky është problemi me të cilin ballafaqohen të gjitha ndërmarrjet publike në shtetin tonë.
- Punët në projektin “Siguria e ujit dhe Mbrojtja e kanalit” janë realizuar me dinamikë dhe kualitet të kënaqshëm në terren. Ndërkohë, kemi pasur zgjatje të afatit për përfundimin e punëve, deri me 30.06.2025, kur besohet se projekti do të përfundoj në tërsësi.
- Refuzimi nga MBPZHR në kërkësen tonë për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore përgjatë kanalit tonë. Kjo na ka shtyrë të komunikojmë me kryetarët e komunave dhe drejtorët e Drejtorive të Bujqësisë dhe përfundimisht kemi nënshkruar 4 Marrëveshje Bashkëpunimi për subvencionimin e ujitjes për bujqit në Komunat e Mitrovicës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Obiliqit.
- Implementimi i rregulloreve për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes (organogramin) dhe atë të sistematizimit dhe përshkrimtit të vendeve të punës, duke vazduhar përmes konkurseve të brendshme dhe të jashtme në mënyrë që të përfundojmë procesin e riorganizimit të ndërmarrjes, e me këtë të bëhet edhe rritja e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që i ofron ndërmarrja jonë.
- Kemi arritur që të përfshijmë në bashkëpunim të rregullt stafin tonë në pjesën e veriut ku bënë pjesë HC Ujmani, Diga e madhe e Ujmanit si dhe ajo e Pridvoricës. Në HC Ujman është kompletuar stafi edhe me 19 punëtorë të ri, kryesisht të komunitetit serb dhe tani Njësia e Ujman numëron 40 punëtorë. Poashtu në kuadër të Departamentit të Ujit dhe Gjenerimit kemi funksionalizuar një shërbim të ri “Shërbimi për mirëmbajtjen e Digave dhe të Infrastrukturës përreth”.
- Gjatë vitit kemi pasur vizita të shumta zyrtare, të komisioneve parlamentare dhe Ministrite të ndryshme por edhe vizita studimore dhe turistike mbi digën e Ujmanit duke përcuar mesazh të

qartë se N.H „Ibër-Lepenci” është një ndërmarrje e vetme që i përfshin të gjitha asetet e sajë dhe i jep përgjegjësi vetëm institucioneve të Republikës së Kosovës.

- Nga data 1 Shkurt është funksionalizuar bursa e përbashkët Shqipëri – Kosovë, ALPEX, anëtarë të së cilës jemi edhe ne, gjë që ka bërë që të hyrat e ndërmarrjes të rriten por edhe të jetë stabile.
- Menaxhimi shumë efikas i ujit të liqenit të Ujmanit, edhe pse në nivelin më të ultë nga paslufta janë arritur të gjitha synimet dhe janë plotësuar në përpikmëri kërkesat e KRU-ve regionale, industrisë, fermerëve dhe ALPEX-it.
- Reagimi në situatën emergjente të krijuar pas sulmit terrorist në infrastrukturën tonë në fshatin Varage, komuna e Zubin Potokut, ku kemi dëshmuar kompetencë dhe aftësi profesionale dhe organizative duke parandaluar një situatë tepër të rrezikshme për Republikën e Kosovës. Kjo pastaj rezultoi me rritjen e sigurisë dhe bashkëpunimin e thelluar me autoritete qendore dhe ato lokale.

SFIDAT:

- Një ndër sfidat kryesore ka qenë dhe do të jetë ndryshimet klimatike që po ndodh në planetin tonë e i cili gjithnjë e më shumë po e bënë të paqartë situatën me reshjet e rrjedhimisht edhe me nivelin e liqenit dhe sigurinë e vijueshmërisë së shërbimeve tona ndaj klientëve tonë. Viti 2024 është karakterizuar me këtë problem ku kërkesat kanë qenë të rritura nga:
 - a) Fermerët për shkak të thatësirave dhe nevojës së rritur për ujite;
 - b) Nga KRU-të për shkak të rritjes së numrit të banorëve gjatë muajve të verës si rezultat i ardhjes masive të diasporës sonë;
 - c) Kërkesës së shtuar të termocentraleve e posaçërisht të termocentralit A, për shkak se lumi Llap nga furnizohet ky impiant për ftohjen e turbinave është tharë gjatë muajve të verës, si dhe
 - d) Nevojës së rritur për energji për shkak të sezonit turistik në Shqipëri.

Për t'i përbushur të gjitha këto nevoja është e domosdoshme të kemi një nivel të caktur të prurjeve të ujit gjatë vitit në Ujman e që fatkeqësisht kohët e fundit nuk po ndodh .

- Infrastruktura dhe pajisjet e N.P.H “Ibër – Lepenc” Sh.A janë të stërvjetuara dhe kërkojnë riparim apo edhe ndërrim të tërësishëm e posaçësht pjesa e pajisjeve. Në shumicën e rasteve ato janë të prodhua nga prodhuesit në ish Jugosllavi e të cilën nuk funksionojnë më dhe tani shfaqet problemi i servisimeve apo i ndërrimit të pjesëve rezervë e që nuk mund të gjinden në treg e në Kosovë aq më vështirë. Poashtu këto pajisje nuk korrespondojnë aspak me standardet bashkëkohore as nga funksionimi por as nga aspekti i eficiencës së energjisë dhe mbrojtjes së ambientit. Tani shtrohet nevoja fillimisht për studime fizibiliteti të cilat do të na tregonin se çka duhet bërë me pajisjet ekzistuese e pastaj edhe renditet edhe pjesa financiare sepse ndërrimi eventual i tyre kërkon kosto të madhe financiare të cilën ndërmarrje nuk mundet ta bartë vetë.
- Puna në hartimin dhe implementimin e rregulloreve për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes (organogramin) dhe atë të sistematizimit dhe përshkrimit të vendeve të punës.
- Siguria e kanalit dhe kualiteti i ujit, janë esenciale për ndërmarrjen tonë por edhe për gjithë vendin e që më së miri u pa me rastin e sulmit terroristë në Varage. Kanali duhet të jetë i sigurtë

por edhe të ofroj siguri për qytetarët që jetojnë përreth. Me futjen e kanalit në listën e infrastrukturës kritike, sigurinë fizike për kanal do ta merrte Policia e Kosovës. Sa i përket sigurisë së kanalit për qytetarë dhe rritjen e kualitetit të ujit, ne jemi duke zbatuar rehabilitimin e kanalit në 12 km gjatësi nga 25 km sa ka në total kanal të hapur. Besojmë që këtë projekt ta vazhdojmë vitin e ardhëm edhe për pjesën e mbetur të kanalit. Për të rritur sigurinë në kanal dhe për të informuar e sensibilizuar opinionin dhe komunitetin përreth kanalit, ne gjatë vitit, kemi vendosur 7 ura të reja dhe shenja paralajmëruese për qytetarë për rrezikun nga kanali. Jemi në pritje të studimit të fizibilitetit përmundësinë e vendosjes së paneleve solare përgjatë kanalit i cili do të kishte përfitim të shumëfishtë për ndërmarrjen tonë edhe nga aspekti i sigurisë, kualitetit të ujit por edhe si e hyrë shtesë.

Syntezat kryesore:

- Rritja e eficiencës së prodhimit të energjisë në Hidrocentralin e Ujmanit, vartësishet nga të dalurat e studimit të fizibilitetit.
- Riparimi i kanalit sekondar Besi – Graçankë në gjatësi prej 22 km me çka do të mundësohet përdorimi i ujit të kanalit tonë në stacionin e Badovcit kua atje ka problem me mangan, që pamundëson furnizimin e rreth 30% të banorëve me ujë të cilët janë të lidhur në këtë sistem.
- Modernizimi i rrjetit të ujitjes dhe kontrolli më i rreptë i shfrytëzimit racional të Ujit nga Ibër – Lepenci nga fermerët lokal për ujitjen e ngastrave të tyre. Dalëngadalë të ndryshohet sistemi i ujijtjes i cili është i vjetër mbi 50 vjet dhe të funksionalizohet edhe SCADA në funksion të ujijtjes.
- Vazhdimi i projektit “Siguria e ujit dhe Mbrojtja e kanalit” edhe në pjesën e mbetur të kanalit të hapur. Kjo do të bëhet me mjete vetanake ose në bashkëpunim me ndonjë institucion ndërkombëtarë. Kanali është në gjendje të rënduar për shkak të vjetësisë së betonit dhe ekspozimit ndaj kushteve atmosferike gjatë këtyre 50 viteve
- Ne si ndërmarrje po bëjmë gjithçka që është e mundshme nga ana jonë në mënyrë që të përshpejtohet realizimi në terren i projektit të Lepencit, i cili së shpejti do të jetë në fazën e diskutimit publik të projektit dhe me shpresë se deri në fund të vitit mund të tenderohet faza e parë e saj, penda e Firajës dhe kanali nëntokësorë i Gaçkës.

Ky raport përbledh shumicën e aktiviteteve, arritjet dhe sfidat e NPH “Ibër-Lepenc” Sh.A. për vitin 2024 duke treguar një progres të qëndrueshëm në shumë fusha operative dhe strategjike të ndërmarrjes.

3. Raporti vjetor i punës për Vitin 2024 nga Zyrtari për Auditim të Brendshëm

Në kuadër të Planit Strategjik të Auditimit të Brendshëm për periudhën 2022-2024 dhe Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm, si dhe kërkesave të Komisionit të Auditimit, Njësia e Auditimit të Brendshëm është angazhuar në realizimin e objektivave të auditimit për vitin 2024. Fokusimi kryesor ka qenë vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, zbatimi i kërkesave për pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret, si dhe përgatitja e pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (SNRF).

Auditimet kryesore të realizuara përfshijnë: arkëtimin e llogarive të arkëtueshme nga shitja e ujit, shpenzimet tjera, shitjen e energjisë elektrike, shfrytëzimin e pushimeve vjetore, dëmet e shkaktuara dhe pagesat të kryera. Po ashtu, janë kryer auditime të kërkua nga Komisioni i Auditimit dhe verifikimi i implementimit të rekomandimeve nga raportet e mëparshme.

Në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin përkatës, janë ekzaminuar dokumentacionin relevant dhe kemi verifikuar funksionimin e sistemeve dhe procedurave të kontrollit të brendshëm. Në raste të caktuara, kemi monitoruar zbatimin praktik të procedurave.

Përveç auditimeve, janë ofruar edhe këshilla për menaxhmentin në lidhje me organizimin, funksionimin e kontrollit të brendshëm, dhe avancimin e procedurave dhe rregulloreve për të përbushur praktikat më të mira. Kemi bashkëpunuar me auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm

Në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të Brendshëm, i hartuar bazuar në Planin Strategjik 2022-2024, si dhe vlerësimin e rrezikut dhe funksionimit të kontrollit të brendshëm, gjatë vitit 2024 janë realizuar auditime në ato fusha të veprimtarisë që janë konsideruar me nivel të lartë rreziku për arritjen e objektivave të planifikuara. Këto auditime kanë pasur për qëllim verifikimin e funksionimit, përputhshmërisë dhe zbatimin praktik të rregulloreve të brendshme, ligjeve përkatëse, si dhe aplikimin e standardeve të kontabilitetit dhe praktikave më të mira.

Gjatë vitit 2024, ne tremujorin e fundit Njësia e Auditimit të Brendshëm është plotësuar edhe me Zyrtarin e Auditimit/Drejtoren e Njësisë. Kjo ka ndihmuar në përbushjen e detyrate të auditimit, pavarësisht burimeve të kufizuara njerëzore. Pra, është arritur që të realizohen të gjitha auditimet e planifikuara brenda vitit, duke siguruar përbushjen e kërkesave të Komisionit të Auditimit.

Pas çdo auditimi, janë paraqitur raporte të detajuara të gjetjeve dhe rekomandimeve për Komisionin e Auditimit, Bordin e Drejtoreve, Kryeshefin Ekzekutiv, Menaxhmentin dhe njësitë e audituara, dhe janë pranuar planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve. Po ashtu, kemi monitoruar zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe kemi ofruar mbështetje këshillimore për Menaxhmentin në proceset dhe rrjedhat tjera të rëndësishme të ndërmarrjes.

Për informimin e Komisionit të Auditimit, para çdo takimi mujor, janë përgatitur dhe paraqitur raportet e auditimit gjatë gjithë vitit 2024. Përveç detyrate të planifikuara, janë realizuar edhe auditime me kërkesë nga Komisioni i Auditimit, jashtë Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm.

Gjatë tremujorit të fundit të vitit 2024, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur dhe miratuar Statutin e Njësisë së Auditimit, ka hartuar dhe aprovuar Strategjinë e Auditimit të Brendshëm 2025-2027, si dhe ka përgatitur Planin e Auditimit për vitin 2025. Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm, stafi i njësisë ka ndjekur trajnime të edukimit të vazhdueshëm, duke siguruar përditësimin dhe rifreskimin e njojurive me qëllim zbatimin e plotë dhe efektiv të mandatit të saj.

Pra, gjatë vitit 2024, NjAB ka realizuar pesë auditime të planifikuara dhe dy auditime me kërkesë të Komisionit të Auditimit. Në vijim, paraqiten auditimet e kryera gjatë vitit 2024, të cilat janë realizuar sipas planit të punës dhe kërkesave të Komisionit të Auditimit.

Auditimet e planifikuara dhe realizuara sipas Planit Vjetor të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 janë:

1. Auditimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga shitja e ujit;
2. Auditimi i shpenzimeve tjera;
3. Auditimi i shfrytëzimit të pushimit vjetor nga të punësuarit;
4. Auditimi i dëmeve të shkaktuara të tjerëve dhe pagesave të kryera dhe
5. Auditimi i shitjes së energjisë elektrike.

Auditimet e realizuara me kërkesë të Komisionit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2024 janë:

1. Auditimi i kontratës me European Institute of Public Policy LLC dhe
2. Auditimi i pagesave për punë jashtë orarit dhe për punë gjatë natës për muajin qershor 2024.

Nga auditimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga shitja e ujit, auditimi i kontratës me European Institute of Public Policy LLC dhe auditimi i pagesave për punë jashtë orarit dhe për punë gjatë natës për muajin qershor 2024, janë evidentuar gjithsej 9 gjetje dhe janë dhënë 9 rekomandime prej të cilave 7 janë zbatuar plotësisht, ndërsa 2 janë në proces zbatimi.

Nga auditimi i shpenzimeve tjera, auditimi i shfrytëzimit të pushimit vjetor nga të punësuarit, auditimi i dëmeve të shkaktuara të tjerëve dhe pagesave të kryera dhe auditimi i shitjes së energjisë elektrike nuk janë evidentuar gjetje, rrjedhimisht nuk ka pasur rekomandime për zbatim.

Më poshtë paraqiten në formë tabelare të dhënrat e auditimeve të kryera gjatë vitit 2024, duke përfshirë gjetjet dhe statusin e rekomandimeve (të zbatuara, në proces dhe të pazbatuara).

Auditime të kryera gjatë vitit 2024	Të gjetura	Rekomandime	Të zbatuara	Në proces	Të pazbatuara
Auditimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga shitja e ujit	2	2	1	1	-
Auditimi i kontratës me European Institute of Public Policy LLC	4	4	4	-	-
Auditimi i pagesave për punë jashtë orarit dhe për punë gjatë natës për muajin Qershor 2024	3	3	2	1	-
Auditimi i Shpenzimeve tjera	-	-	-	-	-
Auditimi i shfrytëzimit të pushimit vjetor nga të punësuarit	-	-	-	-	-
Auditimi i dëmeve të shkaktuara të tjerëve dhe pagesave të tjera	-	-	-	-	-
Auditimi i shitjes së energjisë elektrike	-	-	-	-	-
Gjithsejt	9	9	7	2	-

Nga gjetjet dhe rekomandimet, gjashtë janë të prioritetit të lartë, një është i prioritetit të mesëm dhe një tjetër i prioritetit të ulët, ndërsa në proces zbatimi është vetëm një rekomandim i prioritetit të mesëm.

Në vijim, në formë tabelare, janë të paraqitura të gjeturat, rekomandimet, prioriteti, komentet e menaxhmentit dhe statusi i të gjeturave për Raportet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2024.

Të gjeturat	Rekomandimet	Prioriteti	Komentet e Menaxhmentit	Statusi
1. Auditimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme nga shitja e ujit				
Vazhdimi i mosarkëtimit të të hyrave nga furnizimi me ujë nga KRU "Mitrovica" sipas afatit të maturimit	Në formë të një letër-kujtese së paku në periudha tremujore të dërgohet si paralajmërim te KRU "Mitrovica" Sh.A gjendja e kërkesave nga llogaritë e arkëtueshme.	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	Në proces
2. Auditimi kontratës me European Institute of Public Policy LLC				
Mos dërgimi i një letër-kujtese së paku në periudha tremujore te KRU "Mitrovica" si paralajmërim për gjendjen e kërkesave nga llogaritë e arkëtueshme	Në rast të mospërfilljes së afatit të pagesave edhe pas pranimit të letër-kujtesës për faturat që kanë kaluar afatin e maturimit, të organizohen takime me menaxhmentin e KRU "Mitrovica" Sh.A për të arritur ndonjë marrëveshje që të mos iniciohen procedurat gjyqësore dhe përbartimore	Prioritet i mesëm	Rekomandimi pranohet	E zbatuar

Gjatë procedurave të prokurimit nuk janë zbatuar kriteret e vendosura për dhënien e kontratës-përgjedhjen e operatorëve ekonomik	Gjatë procedurave të prokurimit të zbatohen kriteret e vendosura në shprehjen e interesit për dhënien e kontratës-përgjedhjen e operatorëve ekonomik	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	E zbatuar
Mungon aprovimi i Bordit të Drejtoreve për zotimin e mjeteve	Gjatë procedurave të prokurimit të zbatohen kriteret e vendosura në shprehjen e interesit për dhënien e kontratës-përgjedhjen e operatorëve ekonomik	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	E zbatuar
Janë realizuar pagesat pa u pranuar shërbimi	Pagesat faturave të pranuara duhet të bëhen vetëm pas verifikimit se shërbimi ka ndodhur apo është pranuar	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	E zbatuar
Mungon arsyeshmëria dhe analiza kost benefit	Shpenzimeve për shërbime të konsulencës duhet t'ju paraprijë arsyshmëri e qartë dhe analizë kost benefit	Prioritet i ulët	Rekomandimi pranohet	E zbatuar

3. Auditimi i pagesave për punë jashtë orarit dhe për punë gjatë natës për muajin Qershor 2024

Vijueshmëria në punë-funksionimi formal i pajisjes së evidentimit te hyrje-daljeve	Kërkesat për angazhim me orë shtesë dhe pastaj shpërblim përtej orarit të rregullt të punës duhet të plotësohen paraprakisht (para ndodhjes se veprimit) dhe te arsyetohen para se të dërgohen për aprovim te KE	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	E zbatuar
Janë paguar orë pune jashtë orari më shumë se sa lejohet me ligjin e punës Neni 23 pika 1	Të përpilohet një rregullore e brendshme në lidhje me plotësimin, nënshkrimin, dërgimin në aprovim të orëve të punës	Prioritet i mesëm	Rekomandimi pranohet	Në proces
Angazhimi i të punësuarave me gjatë se sa orari i plotë i punës	Të shqyrtohen mundësitë për minimizimin e punës më të gjatë se orari i plotë i punës në lidhje me dispozitat e Ligjit te punës, nen 23, pika 2 dhe pika 3	Prioritet i lartë	Rekomandimi pranohet	E Zbatuar

4. Departamenti „Uji dhe Gjenerimi”

Gjatë vitit 2024, Departamenti "Uji dhe Gjenerimi" ka operuar duke i dhënë prioritet dy objektivave kryesore: optimizimin e prodhimit të energjisë elektrike bazuar në çmimet në bursën ALPEX dhe menaxhimin efektiv të resurseve ujore në digën e Pridvoricës dhe kanalin kryesor.

HC Ujmani ka gjeneruar gjithsej **62,897.5 MWh** energji elektrike, me 62,018.28 MWh të injektuara në sistemin transmetues. Prodhimi më i ulët krahasuar me Planin e biznesit reflekton fokusimin në optimizimin e prodhimit bazuar në çmimet e ALPEX-it, prurjet shumë të vogëla dhe duke ruajtur njëkohësisht rezervat e ujit për periudhat me çmime më të favorshme dhe për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm të konsumatorëve dhe sezonës së ujitjes. Në aspektin e menaxhimit të ujit, është arritur distribuimi i **64,228,261 m³** ujë gjatë vitit:

Rritja e distribuimit në TM3 erди si rezultat i kërkesave të larta për ujitje dhe kushteve të thatësisë, ku u rrit kapaciteti i lëshimit nga diga e Pridvoricës në 6 m³/s. Stacionet e pompimit operuan efektivisht, me SP Besi duke realizuar 799.3 orë pune (3,165,288 m³) dhe SP Bivolak 252.3 orë pune (1,179,360 m³).


Një sfidë e rëndësishme ishte sulmi terrorist në akuaduktin "Uglare" më 29 nëntor, i cili është menaxhuar me sukses përmes instalimit të 6 gypave DN900, duke siguruar vazhdimësinë e furnizimit brenda 7 orësh dhe përfundimin e sanimit gjatë dhjetorit.

Pavarësisht sfidave të vitit, përfshirë defektet në stabilitetet elektro-mekanike në TM1 dhe kushtet e thatësisë në TM3-TM4, departamenti ka arritur të:

1. Optimizojë prodhimin e energjisë elektrike duke e përshtatur me çmimet e ALPEX-it.
2. Ruajë nivelet e nevojshme të ujit për furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve.
3. Sigurojë furnizim të pandërprerë për TC Kosova B.
4. Menaxhojë me sukses situatat emergjente duke minimizuar ndikimin në furnizim.


Kjo qasje e balancuar ka mundësuar maksimizimin e vlerës ekonomike të prodhimit të energjisë elektrike, ndërsa është ruajtur siguria e furnizimit me ujë përgjatë gjithë vitit.


Sasitë e distribuara të shfrytëzuesëve të ujit për vitin 2024 në HS IL



Duke pasur parasysh nivelin e ujit në liqe dhe prurjet tejet e vogla, thatësin e madhe përgjat vitit 2024, priorititetet e prodhimit, në HC janë gjeneruar **62,897.5 MWh**, apo **33 %** me pak se sasitë e planifikuara (**93,500.00 MWh**), si pasoj e prurjeve enorme gjatë këtij viti.

Diagrami i gjenerimit të energjisë elektrike për vitin 2024







Prurjet mesatare të ujit në akumulimin në Ujëman gjatë vitit 2021 kanë qenë **$7.4 \text{ m}^3 / \text{s}$** , që do të thotë se kemi pasur prurje përgysëm bazuar në mesataren vjetore, (**$13,05 \text{ m}^3 / \text{s}$**), që është marrë si bazë për projektimin e sistemit dhe të kapacitetit gjenerues të HC Ujman.

Niveli i ujit në akumulim me 1 janar 2024 ka qenë në kuotën 685.28 m (301 mil. m^3 , shkalla 53.5), ndërsa me 31 dhjetor 2024 niveli ka qenë në kuotën 678.46 m (243 mil. m^3 , shkalla 91). Në grafikonin e më poshtëm është paraqitur sasia e ujit (mil. m^3) në fillim të çdo muaji

Ditet e muajit dhe Vëllimi e ujit në mil. m³ për vitin 2024





5. Departamenti „Ujitja”

Departamenti“Ujitja” me të tri Njësit Punuese në Vushtrri, Shkabaj dhe Komoran gjatë vitit 2024 ka vazduar aktivitetet e rregullta në kryerjen e detyrave dhe punëve të dala nga Plani i Biznesit për këtë vit, duke u bazuar edhe në Rregulloren për Shfrytëzimin e Sistemit të Ujitjes, dhe konform rrethanave dhe kushteve atmosferike të krijuara gjatë tërë vitit 2024. Punëtorët në terren gjatë tërë vitit kanë bërë kontrollimin e infrastrukturës së ujitjes, që sistemi i ujitjes të jetë i mbrojtur nga ndërhyrjet e ndryshme keqbërëse .

Gjatë tërë vitit punët kanë vazduar në përgatitjen e sistemit për ujitje, mirëmbajtjen e rregullt të sistemit të ujitjes, rehabilitimin e sistemit te ujitjes, furnizimi i fermerëve më ujë gjatë sezonit të ujitjes dhe përgatitjen e sistemit për dimërim. Departamenti ”Ujitja” gjatë vitit 2024 ka mbajtur takime me faktorët relevant për zhvillimin e bujqësisë siç janë: Ministria e Bujqësisë, Drejtoritë e Bujqësisë nëpër komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas me shoqatat e fermerëve dhe fermerët individual. Takime sipas nevojës kemi mbajtur edhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe kompanitë punëkryerëse për shkak të problemeve që kanë dalë gjatë ndërtimit të rrugëve magjistrale, të cilat e kanë atakuar sistemin e ujitjes, sidomos në rrugën Prishtinë-Vushtrri. Kemi ndërmarrë veprimet e duhura në tre drejtime që sezoni i ujitjes të fillojë më kohë dhe furnizimi më ujë të jetë sa më i mirë dhe i sigurt :

-**Përgatitja teknike e sistemit për fillimin e sezonit** - rehabilitimi i të gjitha defekteve në sistem.

-**Kampanja-** informimi i fermerëve për fillimin e sezonit të ujitjes.

-**Kontraktimi** - kontraktimi i sipërfaqeve për ujitje.

- **Përgatitja teknike e sistemit:** me përmirësimin e kushteve atmosferike, në fillim të muajit Mars, janë bërë vizitat në terrenështë vlerësuar gjendja teknike e sistemit të ujitjes dhe duke u bazuar edhe në kërkesat e fermerve për ujitje, janë vendosur prioritetet për rehabilitimin, aftësimin e sistemit të ujitjes për fillimin e sezonit të ri.

Në këtë drejtim bazuar në planin operativ eshtë punuar në riaftësimin e pjesëve të sistemit të ujitjes, i parapar me plan duke përfshirë: gypat, komplet fazoneria, deri tek hidranti.

Sistemi i ujitjes gjatë vitit 2024 ka qenë i rehabilituar në rreth 9813.00 ha, pra mundësitet për ujitje kanë qenë në 9813.00 ha të tokave bujqësore ku shtrihet sistemi i ujitjes “Iber-Lepenc”.

- **Kampanja:** eshtë bërë informimi i fermerëve për kohën e fillimit të furnizimit më ujë, për ujitjen e tokave bujqësore, mundësitet e N.H., „Ibër-Lepenc” për furnizimin e fermerëve më ujë në lokacione të caktuara ku sistemi eshtë i rehabilituar.

Informimi i fermerve eshtë bërë përmes shpërndarjes së letërinformimeve nëpër çdo fshat ku eshtë i shtrirë sistemi i ujitjes dhe janë informuar edhe drejtoritë e bujqësisë nëpër komuna. Informimin e kemi bërë përmes mjeteve të shkruara dhe elektronike, përmes rrjetave sociale, punëtoret e terrenit, me anë të bisedave të drejtpërdrejta më fermerët.

Drejtori i Departamenti”Ujitja”, se bashku me menaxhmentin dhe Udhëheqësit e Njësive Punuese ka organizuar takime/komunikime më kryetarët e komunave, Drejtoratët e Bujqësisë nëpër komuna dhe takimet e drejtpërdrejta më fermerët. Në këto takime/komunikime janë diskutuar mundësitet për Memorandumet e Bashkëpunimit në mes të N.H.”Ibët-Lepenc” dhe komunave, për problemet e përbashkëta rreth ujitjes se kulturave bujqësore, gjendjen teknike e sistemit të ujitjes , probleme tjera që kanë të bëjnë me kushtet dhe nivelin e zhvillimit të fermerëve.

Kontraktimi- Kontraktimi i sipërfaqeve për ujitje ka filluar më kohë, që nga muaj Prill 2024, dhe ka vazduar deri në fundin e muajt Qershor. Kontraktimi i sipërfaqeve për ujitje kryesisht behet në zyrat e Njësive Punuese, mirëpo për lehtësimin e kësaj procedure dhe që fermerëve tu

bëhet sa me i lehtë kontraktimi i ujitjes, teknikët e ujitjes dalin në terren, nëpër ara, apo nëpër shtepitë e fermerëve dhe bëjnë kontraktimin e sipërfaqeve për ujitje. Gjatë vitit 2024 janë kontraktuar dhe ujitur gjithsejtë **1752.62** hektar.

Ujitja- Sezoni i ujitjes ka filluar më kohë, pra më datë një Qershori ujital ka filluar në të tri Njësitë Punuese, duke u bazuar në rregulloren për shfrytëzimin e sistemit të ujitjes, ujital ka vazhduar deri më 30 Shtator 2024. Sistemi i ujitjes, pra rrjeti i gypave nentokë është mbushur më ujë, bazuar në përshkrimin teknik dhe në mënyrë profesionale pa pasur asnjë avari, apo dëmtim të rrjetit të gypave. Punëtoret në terren janë kujdesur përfurnizimin më ujë të fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore si në kuptimin cilësor ashtu edhe në atë sasior, se furnizimi me ujë i fermerëve gjatë tërë sezont të ujitjes 2024, ka qenë shumë i mirë. Shtypja e ujit nëpër hidranta është mbajtur brenda kritereve të rregullores përfshirë shfrytëzimin e sistemi të ujitjes, që do të thotë se shtypja në hidranta ka qenë 2.5 – 5 bar. Gjatë sezont të ujitjes, teknikët e meliorimeve kanë bërë evidentimin e sipërfaqeve të ujitura dhe kanë konstatuar përputhshmërinë e kontratës përfshirë dëmtimin e gypave dhe fazonerisë, por falë ndërhyrjeve të shpejta të ekipave në terren këto defekte nuk kanë ndikuar në vonesa apo cilësinë e ujitjes. Vlerësojmë se ngritja e nivelit të bashkëpunimit me fermerët si dhe ngritja e përgjegjësisë se punëtorëve do të ndikojnë në ngritjen e sipërfaqeve të ujitura.

Më Planin e Biznesit të vitit 2024, kemi paraparë që fermerët mund të ujisnin rrëth 1500 ha, por si rezultat i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet N.H. "Iber-Lepenc" dhe komunave Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Mitorivicë dhe kushteve atmosferike, fermerët e kanë shfrytëzuar ujin përfshirë ujitjen e kulturave bujqësore përfshirë 1752.62 ha, e që në përqindje i bie se plani i ujitjes është tejkaluar rrëth 17%. Në vazhdim me anë të tabelës paraqiten sipërfaqet e planifikuara përfshirë vitin 2024 dhe ato të ujitura nga viti 2021 deri më 30 Shtator 2024.

Tabela 1

Nr .	Njësia Punuese	Sipërfaqë e instaluara ha.	Sipërfaqë e rehabilitua ra ha.	Sipërfaq e ujitura ha. 2021	Sipërfaq e ujitura ha. 2022	Sipërfaq e ujitura ha. 2023	Sipërfaqë e planifikuara ha. 2024	Sipërfaq e ujitura ha. 2024
1	Vushtrri	7200.00	4500.00	533.02	734.28	680.00	680.00	824.39
2	Shkabaj	7100.00	2500.00	285.25	685.81	560.00	620.00	727.39
3	Komoran	5620.00	2813.00	144.26	459.63	111.00	200.00	200.84
TOTAL:		19920.00	9813.00	962.53	1879.72	1351.00	1500.00	1752.62

Paraqitja grafike e sipërfaqeve të ujitura në ha, ndër vite 2000 – 2024



Vështirësitë

Gjatë vitit 2024 jemi përballë më shumë probleme dhe vështirësi duke përfshirë këtu problemet e ndërtimeve në afërsi dhe mbi sistem të ujitjes, të cilat kanë ndikuar që ujitja të mos realizohet në mundësit dhe kapacitet që ka kompania N.H. "Ibër-lepenc".

Gjithashtu ndrrimi i destinacionit të tokave bujqësore me infrastrukturë të ujitjes, derdhja e ujërave të zeza në kanalet e ujitjes, niveli i ulët i zhvillimit te bujqësisë, ndërtimet mbi sistemin e ujitjes dhe toka bujqësore e ngelur e pa punuar nën sistemet e ujitjes. Këto lloj punimesh mbi dhe për rreth sistemit të ujitjes, e dëmtojnë në masë të madhe sistemin e ujitjes, nëse vazhdohet me këtë ritëm mund të vijë edhe deri të zgogëlimi (pasivizimi) i sipërfaqeve të tëra të ujitjes së tokave bujqësore. Përkundër të gjitha vështirësive që po e përcjellin sektorin e bujqësisë: problemet me shitjen e produkteve bujqësore, niveli i ulët i zhvillimit të fermerëve, mungesa e fuqisë punëtore, plani i ujitjes është tejkaluar për rreth 17 %, pra nga 1500 ha, të planifikuar janë ujitur 1752 ha.

Konkluzion

Departamenti "Ujitja" bazuar në Planin e Biznesit gjatë tërë vitit 2024, ka realizuar objektivat në:

- Përgatitjen e sistemit të ujitjes për fillimin më kohë të sezonit të ujitjes,
- Fillimin më kohë të ujitjes;
- Mirëmbajtjen e vazhdueshme të sistemit gjatë ujitjes;
- Furnizim me ujë i fermerve: më kohë, më sasi dhe më cilësi te duhur, për ujitjen e tokave bujqësore;
- Investimet kapitale përfunduar; përfundimi më kohë i sezonit të ujitjes, pra më 30 Shtator
- Përgatitja e sistemit të ujitjes për dimërim (zbranje e sistemit dhe konzervimi i tij).

Përkundër faktit se më Planin e Biznesit të vitit 2024, kemi paraparë që fermerët mund të ujisnin rreth 1500 ha, por si rezultat i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit ndërmjet N.H. "Ibër-Lepenc" dhe komunave Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Mitrovicë si dhe kushteve atmosferike, fermerët e kanë shfrytëzuar ujin për ujitjen e kulturave bujqësore për 1752.62 Ha, e që në përqindje i bie se plani i ujitjes është tejkaluar për rreth 17 %. Përkundër të gjitha vështirësive që po e përcjellin sektorin e bujqësisë në vendin tonë, shpresojmë për një të ardhme më të mirë të bujqësisë, çka do të mundësonte shfrytëzimin edhe më të madh të kapaciteteve të instaluara të ujitjes në Hidro-Sistemin "Ibër-Lepenc". Duhet theksuar se Departamenti "Ujitja" ka ofruar shërbime në këto komuna: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas, por fermerët bazuar në kushtet dhe rrethanat e lartekura kanë ujitur vetëm **1752.62 Ha**.

6. Shërbimi i Financave

Të hyrat

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2024 të hyrat e ndërmarrjes janë realizuar në vlerë **11,344,018.52 €**, ndërsa ishin planifikuar të realizohen në vlerë prej **7,251,230 €**. Shprehur në përqindje realizimi i të hyrave është për **56%** më i lartë se planifikimi i tyre ndërsa për **10%** më i lartë në krahasim me vitin paraprak, të njejtës periudhë.

- Nga energjia elektrike janë realizuar të hyrat në vlerë prej **8,417,231.82€**, ndërsa kanë qenë të planifikuara të realizohen të hyrat në vlerë **4,675,000€** apo shprehur në përqindje realizimi ishte për **80 %** më i lartë në krahasim me të hyrat e planifikuara dhe **8%** më i lartë se në vitin 2023 të njejtës periudhë.
- Nga shitja e ujit të papërpunuar janë realizuar të hyrat në vlerë prej **2,490,956.76 €**, ndërsa të planifikuara ishin **2,338,623 €**. Realizimi është më i lartë se planifikimi për **7%** e ne krahasim me vitin e kaluar është më i lartë për **11%**.
- Nga shitja e ujit për ujite janë realizuar të hyrat në vlerë prej **192,788 €**, ndërsa të planifikuara ishin **165,000 €**. Realizimi është më i lartë se planifikimi për **17%** e në krahasim me vitin e kaluar është më i lartë për **28%**.
- Të hyrat tjera në vlerë **243,041.74 €** janë të ardhura nga interesit bankar, donacionet dhe të hyrat e shtyera.

Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të hyrat sipas llojit, sasisë dhe vlerës monetare:

Raporti i të hyrave për përiudhën Janar-Dhjetor 2024

N.r.	Emërtimi	Njësia matëse	Realizim Janar-Dhjetor 2023	Plani Janar-Dhjetor 2024	Realizimi Janar-Dhjetor 2024	% e realizimit në raport me planin	Indeksi 2023
			1	2	3	4	
1	TË HYRAT		10,313,254	7,251,230	11,344,019	156	110
1.1	Energjia elektrike	€	7,818,043	4,675,000	8,417,232	180	108
1.2	Uji	€	2,242,119	2,338,630	2,490,957	107	111
1.3	Ujitja	€	150,516	165,000	192,788	117	128
1.4	Të tjera	€	102,575	72,600	243,042	335	237

Të hyrat në euro për periudhën Janar-Dhjetor 2024, krahasuar me planin dhe realizimin e vtitit të kaluar.



Shpenzimet


Gjatë të vitit 2024 shpenzimet e ndërmarrjes kanë arritur vlerën prej **4,896,078.68€**, ndërsa ishin planifikuar të shpenzohen **5,121,075€**, pra realizimi i shpenzimeve është nën planifikim për **4 %**, ndërsa për **3%** nën shpenzimet e realizuara në vitin e kaluar.

Shpenzimet e vitit 2024 me krahasime

N.r.	Emërtimi	Njësia matëse	Realizim Janar-Dhjetor 2023	Plani Janar-Dhjetor 2024	Realizimi Janar-Dhjetor 2024	% e realizimit në raport me planin	Indeksi 2023
2	Shpenzimet	€	5,052,938	5,121,075	4,896,079	96	97

	Realizim Janar-Dhjetor 2023	Plani Janar-Dhjetor 2024	Realizimi Janar-Dhjetor 2024
Të hyrat	10,313,254	7,251,230	11,344,019
Shpenzimet	5,052,938	5,121,075	4,896,079

Të hyrat dhe shpenzimet për periudhën Janar-Dhjetor 2023, krahasuar me planin dhe vitin e kaluar



Rezultati financiar

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor, ndërmarrja ka pasur rezultat pozitiv financiar në vlerë **6,447,939.84 €** dhe pas zhvlersimit ka operuar me fitim prej **1,832,977.00 €¹**.

Pasqyra e të ardhurave 2024 me krahasim 2023

Janar - Dhjetor me krahasime	2024	2023
Pasqyra e të ardhurave	Vlerat në €	Vlerat në €
Të ardhurat nga shitja energjisë elektrike	8,417,231.82	7,818,043.42
Të ardhurat nga shitja e ujit me shumicë	2,490,956.76	2,242,119.20
Te ardhurat nga ujitja	192,788.20	150,516.30
Të ardhurat tjera	243,041.74	102,575.44
Total te ardhurat Bruto	11,344,018.52	10,313,254.36
Pagat dhe meditjet	3,590,734.31	3,790,179.81
Shpenzimet për udhëtime zyrtare	5,065.84	959.02
Reprezentacioni	13,580.85	8,115.57
Shpenzimet e marketingut	-	130.00
Shpenzimet e mirëmbatjes	37,193.01	37,156.45
Shpenzimet komunale	277,708.03	303,207.48
Material harxhues	28,921.71	22,704.91
Material për rrjetin e ujitjes	49,460.74	20,990.68
Shpenzime për shërbime	9,213.90	33,973.06
Shpenzime tjera	124,541.28	36,631.92
Shpenzimet telekomunikuese	22,589.10	15,405.64
Derivatet	42,487.93	38,067.85
Kompenesimi dhe taksat	690,681.98	737,439.23
Kompensimi i dëmeve	3,900.00	7,976.87
Shepnzimet nga imbalanca		
Totali i shpenzimeve	4,896,078.68	5,052,938.49
Fitimi operativ	6,447,939.84	5,260,315.87
Total zhvlersimi	4,614,962.84	4,629,218.97
Total Fitimi (Humbja) Neto	1,832,977.00	631,096.90

¹ Shpenzimet e dëmit nga sulmi terrorist në akueduktin e fshatit Varage, komuna e Zubin Potokut, janë në vlerën e 314,675.4 EUR, të cilat nuk janë përfshirë në fitimin e periudhës 2024, por janë të regjistruara në Pasqyrat Financiare.

Fitimi operativ i vitit 2024 është :

	Realizim Janar-Dhjetor 2023	Plani Janar-Dhjetor 2024	Realizimi Janar-Dhjetor 2024
Fitimi operativ para zhvlersimit	€ 5,260,315.87	€ 2,154,374.35	€ 6,447,939.84

Përshkrimi i planit finanziar për vitin 2024

Plani finanziar për vitin 2024 ishte hartuar duke marrë parasysh faktorët ekonomik dhe strategjite operacionale të ndërmarrjes, me qëllim optimizimin e të ardhurave dhe menaxhimin e shpenzimeve. Objektivi kryesor ishte sigurimi i një strukture të qëndrueshme financiare, duke vënë theksin te ruajtja e stabilitetit dhe rritja graduale e performancës ekonomike.


Në bazë të planifikimit fillestar, fitimi operativ para zhvlerësimit ishte parashikuar të arrinte në **€2,154,374.35**. Ky projeksion është bazuar në analizat e trendeve të tregut, pritshmëritë e rritjes së kërkesës dhe optimizimin e kostove operative.

Krahasimi i performancës së realizuar me planin.

Realizimi për vitin 2024 tejkaloj ndjeshëm pritshmëritë, duke arritur **€6,447,939.84**, që është **199.30%** më shumë se plani.

Krahasuar me vitin 2023, ku fitimi operativ ishte **€5,260,315.87**, rritja për vitin 2024 ishte **22.58%**.

Ky rezultat dëshmon përmirësimin e ndjeshëm të performancës financiare të ndërmarrjes, për shkak të rritjes së të hyrave dhe optimizimit të shpenzimeve. Strategjite e zbatuara, përfshirë investimet e duhura dhe përmirësimet në menaxhimin e kostove, kanë ndikuar në këtë sukses të dukshëm. Për vitin e ardhshëm do të synohet mbajtja e kësaj performance të lartë duke vazhduar me strategji të zgjuara financiare dhe operacionale.



7. Prokurimi

Gjatë vitit 2024, Departamenti i Prokurimit ka zhvilluar tërësisht **95 aktivitete** me vlera të ndryshme monetare përfshirë furnizime, sherbime dhe punë. Nga to, janë firmosur **49 kontrata** nga të cilat: 16 procedura me vlerë të mesme, 16 procedura me vlerë të ulët dhe 17 procedura me vlerë minimale e që në përqindje interferohet: procedurat me vlerë të mesme janë 32.65%, procedurat me vlerë të ulët janë 32.65%, procedurat me vlerë minimale janë 34.69%. Përveç që disa aktivitetë të fundvitit barten në vitin 2025 përfshirë procedura me vlerë minimale janë dështime, për shkak se ka procedura që i kemi shpallur nga 3 herë. Për më tepër kemi edhe aktivitetë të cilat nuk janë planifikuar në Planin Përfundimtar të Prokurimit, por janë shfaqur si aktivitetë të nevojshme dhe të domosdoshme përfshirë funksionimin e drejtë të Ndërmarrjes.

Të Arriturat:

Aktivitetet kanë përfshirë nënshkrimin e kontratave me furnizues të ndryshëm përfshirë projektet e mëposhtme:

- Furnizime me: fazoneri, vajra dhe yndyrna, derivate, materiale zyrtare, material reprezentativ, uniforma pune përfshirë punetoret e Ndërmarrjes, material përfshirë byfe, karrige përfshirë zyre, sistemin e hyrje-daljeve dhe video vëzhgim, firewall-Router dhe Switch, material teknik përfshirë punëtori, ftohës interkuler, autopjesë dhe materiale shpenzuese përfshirë parkun e automjeteve, pajisje të IT, pompe zhytese, mjete pune, goma dhe bateri përfshirë vutura, printerë dhe printer përfshirë ID kartela, Furnizimi dhe montimi i pllakatës informuese në Njesine Punuese në UJMAN.
- Shërbime si: servisimi i veturave, matjet e rezistencave, përtokëzuesve dhe rrufepritësve, mirëmbajtja e largpërçuesve 10kV dhe 35kV, Hartimi i Projekteve për renovimin e objektit N.H „Iber-Lepenc”, sherbime të Serverit përfshirë Ueb Site dhe E-mail Hosting, shqyrtimi i transformatoreve dhe mbrojtjeve në objektet e Ndërmarrjes, studimi i fizibilitetit përfshirë sistemin hidraulik në objekte ndarëse, pultave komanduese dhe modernizimi përfshirë rritjen e eficiencës në stacione pompike, mirëmbajtja e ERP sistemit NAV dhe blerje e licencave shtesë.
- Punë: ndërtimi dhe vendosja e urave metalike përfshirë këmbesore përgjatë kanalit kryesor, sanimi dhe renovimi i objekteve ndarëse dhe stacioneve pompike, sanimi i drenazhës në objektin e zyrës SCADA, rehabilitimi i nyjeve sanitare në Drejtori, ndarja e dy zyreve në objektin e Drejtorisë, riparimi i dy segmenteve me nga $L=90.0\text{m}$ të kanalit në Babin Most, njëri me profil têrthor A11 dhe tjetri A12, ndërrimi i sistemit hidraulik përfshirë ON Hamidi, ON Mihaliq, ON Vernicë dhe ON Vasilevë, Riparimi i turbinave, gjeneratoreve dhe stabilimenteve në HC Ujman Remont.

Sfidat:

- Mospranimi i ofertave është një ndër sfidat më kryesore së fundi që po shkakton përsëritje të aktiviteteve/shpalljeve, e kjo mund të ndodhë përfshirë disa arsyet:
- Ofertuesit nuk dorëzojnë oferta të përshtatshme përfshirë specifikimet ose kërkesat e parashikuara;
- Ofertat mund të janë shumë të larta ose të papranueshme nga ana e buxhetit të caktuar;

- Në disa raste, mungesa e Operatorëve Ekonomik konkurruesh mund të shfaqet dhe kjo mund të ngadalësojë procesin dhe të kufizojë mundësinë për të gjetur mundësi të mira;
- Mundësia e lehtë e ankimimit në OSHP (Organi Shqyrta i Prokurimit): edhe pse ankimimi është një mjet për të mbajtur procesin transparent dhe të drejtpërdrejtë, mundësia e lehtë e ankimimit po shkakton vonesa në marrjen e vendimeve. Kjo gjithashtu po ndikon në afatet e prokurimit dhe po çon në bllokimin e procesit të furnizimit dhe realizimit të aktiviteteve.
- Marrja me vonesë e vendimeve nga OSHP: vonesat në marrjen e vendimeve nga OSHP janë një tjetër sfidë që ndikon direkt në zhvillimin e proceseve të prokurimit. Përgjigjet e ngadalshme nga OSHP mund të shkaktojnë vonesa të papritura dhe mund të krijojnë një bllokim për përbushjen e kërkave dhe nevojave për intervenim ose përfundimin e aktiviteteve të caktuara.
- Rritja e çmimeve dhe tregu jostabil: fluktuacionet e çmimeve dhe pasiguria e tregut janë sfida të rëndësishme për menaxhimin e prokurimit. Kur çmimet ndryshojnë në mënyrë të papritur ose janë jostabile, kjo mund të ndodhë si pasojë e faktoreve të jashtëm (si inflacioni, ndodhitë globale ose ndryshimet e kërkave dhe ofertës). Kjo lloj pasigurie mund të ndikojë në vodosjen e buxhetit të saktë dhe në realizimin e marrëveshjeve me furnizuesit.

Rëndësia e Ndërmarrjes dhe integrimi i aktiviteteve jasht planit:

- Integrimi i aktiviteteve jashtë planit: Edhe pse disa aspekte si prishjet në sistem ose kanale mund të duken si faktorë të jashtëm dhe të paparashikuar, është e rëndësishme t'i përfshijmë këto në strategjinë e prokurimit, duke parashikuar mundësinë për nevojën e riparimeve të shpejta, furnizim me pjesë të ndërrueshme dhe burime emergjente.
- Krijimi i një plati fleksibël dhe të qëndrueshëm: përveç planifikimit të zakonshëm të prokurimit, një plan i qëndrueshëm dhe fleksibël duhet të përfshijë mundësinë për t'u adaptuar ndaj sfidave që vijnë nga ndryshimet e papritura të tregut, rritjes së çmimeve dhe kërkave të papritura për riparime urgjente.
- Menaxhimi i papriturave: një pjesë e rëndësishme e planit të prokurimit është mundësia për të menaxhuar papriturat dhe të sigurohem që mund të reagojmë shpejt ndaj ndonjë prishje të mundshme në sistem që mund të kërkojë ndërhyrje urgjente dhe materialet përkatëse.

Vlen të theksohet që është e rëndësishme se menaxhimi i risqeve, përmirësimi i proceseve dhe adaptimi ndaj kushteve të tregut mund të përmirësojnë rezultate dhe të ndihmojnë në menaxhimin e pasigurisë në prokurim. Kjo edhe duke u nisur nga dinamizmi i shtuar i aktiviteteve dhe punëve të Ndërmarrjes që na obligon të realizojmë dhe përbushim misionin dhe vizionin e Ndërmarrjes. Në vazhdim janë të listuara kontratat e firmosura:

#	Emërtimi	Vlera e parashikuar	Vlera e kontraktuar
1	Furnizim me karrige për zyre	18,000.00	15,860.03
2	Mirëmbajtaja e ERP sistemit NAV dhe blerje e licencave shtesë	25,000.00	24,756.40
3	Ndarja e dy zyreve ne objektin e Drejtorisë	10,000.00	6,898.28
4	Reabilitimi i nyjeve sanitare në Drejtori	13,000.00	10,322.64

5	Furnizim me sistem për hyrje – dalje dhe video vëzhgim	15,000.00	14,834.00
6	Furnizim me Firewall, Router dhe Switch	40,000.00	38,429.83
7	Sanimi i drenazhës në objektin e zyrës SCADA	5,000.00	2,133.75
8	Furnizim me flamuj të vegjël dhe flamuj të mëdhenjë me shtiza	800.00	797.68
9	Furnizim me dy MFP Printer Color A4	3,200.00	2,832.00
10	Furnizim me material higjenik	5,800.00	3,761.70
11	Studimi i fizibilitetit për sistemin hidrualik në objekte ndarese, pultave komanduese dhe modernizimi për rritjen e eficiences në stacione pompike - RITENDER	20,000.00	14,960.00
12	Furnizimi dhe vendosja e aktutatorëve në valvula 600 në SP Bivolak - RITENDER	40,000.00	39,990.20
13	Riparimi i Eskavatorit	990.00	990.00
14	Furnizim me pajisje higjenike	800.00	342.85
15	Riparimi i Kamionetës Renault Master	2,500.00	2,082.70
16	Furnizim me pije për byfe	6,700.00	4,639.76
17	Shqyrtimi transformatoreve dhe mbrotjeve ne objektet e Iber Lepencit	5,000.00	3,101.40
18	Furnizim me material teknik për punëtorinë mekanike Shkabaj	14,000.00	13,617.53
19	Shërbime të serverit për Ueb Site dhe E-mail Hosting	990.00	979.40
20	Servisimi i 3 Automjeteve - RITENDER	2,090.00	1,883.28
21	Furnizimi dhe montimi i Pllakës informuese për Nj.P Ujmani	700.00	
22	Furnizim me uniforma dhe mjete mbrojtëse në punë	20,000.00	15,798.55
23	Furnizim me vajra dhe yndyrna për SP dhe ON dhe NJP Ujmani	12,000.00	11,994.68
24	Furnizim me fazoneri - RITENDER 2	120,000.00	114,016.32
25	Furnizim për paisje të TI për ndërmarrje	980.00	973.11
26	Balancimi i elektromotorit me Pompën në SP Samadrexhë, NJP Vushtri	1,950.00	1,942.00
27	Furnizim me Volant (Zamajc) për veturën Shkoda Yeti	350.00	290.00
28	Furnizimi dhe montimi i baterive stacionare në SP Çagllavicë - RITENDER	800.00	800.00
29	Hartimi i projektit për renovimin e objektit „Iber-Lepenc“	980.00	978.00
30	Servisimi i veturës Touareg	650.00	590.00
31	Furnizimi dhe servisimi i aparatave për mbrojtje kundër zjarrit	4,900.00	3,508.79
32	“Furnizim me material ”Dosje për personel”	875.00	561.68
33	Servisimi i Veturës Touareg	1,550.00	1,127.98
34	Sigurimi i automjeteve të IL-së	12,500.00	9,722.81

35	Sanimi dhe renovimi i objekteve ndarëse dhe stacioneve pompike Besi (Besi, Çagllavicë) - RITENDER	210,000.00	170,441.60
36	Ndërtimi dhe vendosja e urave metalike për këmbësor përgjatë kanalit kryesor të IL-së - RITENDER	50,000.00	47,592.65
37	Mirëmbajtja e largpërçuesve 10kV dhe 35kV	7,000.00	6,966.72
38	Matjet e rezistencave, përtokëzuesve dhe rrufepritësve	2,400.00	1,180.59
39	Riparimi i dy segmenteve me nga L=90.0m të kanalit në Babin Most, njëri me profil tërthor A11 dhe tjetri A12	70,000.00	69,653.30
40	Furnizim me ftohes interkuller	750.00	296.00
41	Ndrrimi i sistemit hidraulik për ON Hamidi, ON Mihaliq, ON Vernicë dhe ON Vasileve - RITENDER	80,000.00	79,714.00
42	Servisimi i veturës FORD	2,450.00	1,902.16
43	Bateri për Bager - RITENDER	140.00	135.00
44	Furnizim me mjete pune - RITENDER	999.00	998.53
45	Furnizim me autopjesë dhe materiale shpenzuese për parkun e automjeteve	5,900.00	5,347.76
46	Furnizim me gome dimërore për viture	190.00	190.00
47	Furnizim me bateri për veturë - RITENDER	400.00	390.00
48	Furnizim me material reprezentativ	6,700.00	6,249.28
49	Furnizim me pritner për ID Kartela	996.00	996.81

INVESTIMET KAPITALE TE PLANIFIKUARA NE PLANIN PERFUNDIMTAR TE ROKURIMIT-2024 DHE REALIZUARA

Në vitin 2024, Ndërmarrja ka planifikuar në Planmin e Prokurimit një total investimesh kapitale prej **2,626,200.00 €**, për zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës dhe teknologjisë, përmirësimin e objekteve dhe pajisjeve, dhe zhvillimin e resurseve për përdorim afatgjatë.

Investimet kapitale të realizuara janë ato projekte që kanë kaluar nga faza e planifikimit dhe prokurimit në fazën e ekzekutimit dhe kanë përfunduar me sukses. Ky proces përfshin shpenzimet reale që janë realizuar për projekte të caktuara dhe ndikimin e tyre në përmirësimin e infrastrukturës, teknologjisë, pajisjeve dhe shërbimeve. Nga investimet e planifikuara, kemi arritur që ti kontraktojmë/realizojmë **656,763.75 €**, e që në përqindje interprehohet sikur **25.1%** e planit që është realizuar. Përkundër faktit se synimet, përpjekjet dhe aktivitetet tona janë ndërmarrë për realizimin e plotë të Investimeve Kapitale të planifikuara, realizimi i plotë nuk është arritur për shkak të zvarritjeve të aktiviteteve me ankesa dhe në pritje të stërgjatura të Vendimeve të Panelit të OSHP, disa janë anuluar e disa janë proceduar në vitin 2025 për realizim/kontraktim, apo edhe për shkak të mospranimit të ofertave të përgjegjshme sipas LPP, ndërsa ka edhe aso aktivitete që janë shtyer për t'u realizuar në fillim të vittit 2025.

Gjithashtu vlen të potencohej se kriter I dhënjes së kontratës zakonisht është “çmimi më I ulët me ofertë të përgjegjshme”, andaj konsiderojme se përqindja e realizuar në vlerë monetare nuk pasqyron mosrealizim të planifikimit të investimeve, sidomos duke parë se kemi pasur investime kapitale edhe të paplanifikuara, por që janë shfaqur si domosdoshmëri për riparim dhe funksionalizim të infrastrukturës, e pajisjeve për të kryer misionin dhe arritur vizionin e Ndërmarrjes.

Ndërsa Shpenzime Operative janë planifikuar **308,353.00 €**, dhe nga to janë realizuar **100,803.90 €**, e që në përqindje interprehohet sikur **32.6%** e planit që është realizuar.

Përfundim: Investimet kapitale dhe shpenzimet Operative janë një pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës së Ndërmarrjes sonë. Procesi i planifikimit dhe ekzekutimit të këtyre investimeve është i qartë dhe i monitoruar për të siguruar që shpenzimet janë në përputhje me objektivat e vendosura dhe që rezultatet janë në nivelin e pritshëm. Raportimi i këtyre investimeve ka për qëllim që të lehtësoj në menaxhimin efikas të fondeve dhe siguron transparencë dhe përgjegjshmëri të Ndërmarrjes.

Njëkohësisht, ju lutem shikoni të dhënat për Investimet Kapitale të Projektit të Bankës Botërore: Deri ne fund te viti 2024, progresi i punimeve është si më poshtë:

Punimet e perfunduara	8,156,503.34 €
Përqindja e punimeve të kryera	63.94%
Punime te certifikuara/paguara	5,883,839.13
Përqindja e punëve të certifikuara	45.70% ^[1]

8. Departamenti i Shërbimeve të Përbashkta

Ky vit e ka gjetur Departamentin e Shërbimeve të Përbashkëta me realizimin e projekteve shumë të rëndësishme për ndërmarrjen, ku dy prej tyre më të rëndësishmet dhe të cilat kanë ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe performancës së brendshme duke arritur një sukses në realizimin e objektivit kryesor, atë të digitalizimit të Administratës si dhe rritjes së sigurisë së rrjetit brenda drejtorisë si dhe të gjitha njësive punuese të ndërmarrjes. Ju informojmë që pas shumë sfidave disa vjeçare kemi arritur të implementojmë projektin e instalimit të Firewallëve (Pajisje mbrojtëse të rrjetit) dhe Ruterëve modern në Drejtori dhe nëpër Njësitë Punuese Shkabaj, Komoran dhe Vushtrri si dhe krijimin e një rrjeti të brendshëm të sigurt duke eliminuar shumë probleme, që kanë përcjellur deri më tani dhe njëkohësisht duke rritur sigurinë, mbrojtjen e informatave dhe rrjetit në përgjithësi. Vlenë të theksohet se me instalimin e këtyre Pajisjeve moderne kemi eliminuar humbjen e më shumë se 30% të rrjetit tonë i cili ka ardhur si shkak i mos kontrollit të rrjetit. Me këtë rast kemi kufizuar hapësirën e përdorimit të aplikacioneve jozyrtare dhe programeve të paautorizuara të cilat nuk kanë të bëjnë me punët e përditshme të stafit tonë.

Projekti tjeter i rëndësise shumë të madhe e që është perfunduar me sukses është implementimi dhe instalimi i pajisjeve për evidentimin e Hyrjeve/daljeve në drejtori, njësi punuese si dhe në të gjitha objektet ndarëse dhe stacionet pompike të ndërmarrjes duke përfshirë HC Ujmanin. Duke pasur parasysh se kjo ishte kërkesë me prioritet nga Kryeshefi Ekzekutiv që nga marrja e mandatit të tij, si kërkesë për ta rritur llogaridhënjen dhe diciplinën në punë. Tash e tutje me pajisjet e reja dhe softuerin e instaluar në ato pajisje Kryeshefi, Menaxhmenti dhe drejtoritë përkatëse do të jenë në gjendje që në kohë reale të shohin dhe menaxhojnë lëvizjet e stafit të tyre, kontrollojnë në mënyrë më të detajuar vonesat apo daljet pa leje.

Gjatë vitit 2024 janë përfunduar dhe kryer këto aktivitete nga Zyra e IT-së:

Furnizim me sistemin për hyrje – dalje e vijushmërisë në punë

Sipas kontratës Nr. 02-697 të datës 27.02.2024, nr. Prokurimit IL-23-13850-1-2-, ka filluar realizimi i projektit "Furnizim me sistemin për hyrje – dalje dhe video vëzhgim". Me datë 13.02.2024, pas takimit me Operatorin Ekonomik në zyre e ndërmarrjes tonë në Prishtinë, është nënshkruar plani për menaxhimin e kontratës, pas përfundimit të procedurave është bërë porosia për 20 copë pajisje për hyrje/dalje dhe një sistem për menaxhimin e vijushmërisë në punë. Duke u bazuar në planin për menaxhimin e kontratës kontraktuesi e ka pas obligim që me datë 15.03.2024 të kryej obligimet sipas kontratës. Me datën 18.03.2024 është bërë edhe azhurnimi i Planit Menaxhues, kështu që kontraktuesi me datë 02.04.2024, duhet të bëjë përfundimin e kontratës. Nga data 18.03.2024 deri 28.03.2024 është bërë montimi i pjesës harduerike Time&Attedanceve nga kontraktuesi në prani të komisionit për pranim. Janë bërë dhe formatimet e kompjuterëve të vjetër dhe janë përgatitur për donacion në shkolla, ku do ti përdorin nxënësit gjatë mësimit. Këtë vit jemi fuurnizuar me **Firewall, Router dhe Switch**. Konformë kontratës Nr. 02-475 të datës 09.02.2024, nr. Prokurimit IL-23-13905-1-2-1. Vlenë të ceket se tani janë duke u zhvilluar paralelisht dy projekte shumë të rëndësishme për ndërmarrjen tonë njëkosisht. Punët në projektin SKADA janë duke vazhduar sipas kontratës. Ndërmarrja jonë, tani e sa kohë është në vlugun e implementimeve të projektit të Bankës Botërore, WSCP-G-ICB-2, këto ditë jemi në fazën e përfundimitare të realizimit të projektit SCADA, që implementohet përmes kompanisë/konzorciumi: "JV Inter-Adria dhe Oskar".

Shërbimi i Burimeve Njerëzore në N.P.H "Ibër- Lepenc" Sh.A

Raport lidhur me konkursen e realizuara gjatë vitit 2024 Shërbimi për BNJ ka administruar gjithsejtë 61 Konkurse Publike të Shpallura nga Ndërmarrja. Prej këtyre 61 pozitave të shpallura, procesi i rekrutimit është realizuar suksesshëm për 57 pozitat ku punëtorët kanë nënshkruar kontratat dhe kanë filluar punën e tyre në Ndërmarrje.

Zyra ligjore :

Përveç punëve të zakonshme me të cilat përballet shërbimi ligjor, gjatë periudhës njëvjeçare të vitit 2024 është zhvilluar procedurë për 46 lëndë gjyqësore, ku në 26 raste jemi të paditur dhe në 20 raste jemi paditës. Në secilën lendë janë kryer veprimet procedurale përmes parashtresave të ndryshme. Për këto lëndë gjatë vitit 2024 janë mbajtur në tërësi 113 seanca ku për 14 raste lidhur me çështjen juridike kompenzim dëmi janë mbajtur 37 seanca, për 6 raste lidhur me çështjen juridike kontest pune janë mbajtur 9 seanca, për 6 raste lidhur me çështjen juridike kontest prone janë mbajtur 15 seanca, për 16 raste lidhur me çështjen juridike lirim prone janë mbajtur 51 seanca dhe për 1 rast lidhur me çështjen juridike pengim posedimi është mbajtur 1 sëancë.

Poashtu gjatë vitit 2024 përveç lëndëve në procedurë kontestimore që zhvillohen në gjykata kompetente, shërbimi ligjor ka pasur angazhim edhe në lëndët që janë në procedurë përmbarimore duke përcjellur mbarëvajtjen e ekzekutimit të tyre në kordinim me zyrtarët financiar të ndërmarrjes.

9. Departamenti për Planifikim dhe Zhvillim

I. HYRJE Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim (DPZH) ka vazhduar me implementimin e aktiviteteve dhe projekteve të planifikuara, duke ndjekur strategjinë e miratuar nga N. P.H "Ibër-Lepenc". Aktivitetet janë realizuar në përputhje me rregulloret dhe objektivat e përcaktuara, duke përfshirë projektet e trashëguara nga vitet e mëparshme dhe zhvillime të reja brenda kompetencave të drejtorisë.

II. PROJEKTET E ZHVILLUARA GJATË VITIT 2024, DPZH ka menaxhuar dhe monitoruar projektet sipas kategorive të mëposhtme:

- **Projekte me Shërbime:** 19 projekte
- **Projekte me Furnizime:** 37 projekte
- **Projekte me Punë:** 11 projekte

III. AKTIVITETET KRYESORE TË REALIZUARA

- Përgatitja finale e tabelave të gjitha projekteve të Investimeve Kapitale të Planit të Biznesit për vitin 2025.
- Përgatitja dhe finalizimi i draftit të Strategjisë Zhvillimore për Ndërmarrjen "Ibër-Lepenc" (2025-2035).
- Kontrolli dhe përditësimi i të dhënave gjatë zhvillimit të projekteve ekzistuese nëpërmjet tabelave monitoruese të shërbimeve të DPZH-së.

10.Njësia Implementuese e WSCP

Raporti vjetor i progresit nga 1janari deri më 31 dhjetor të vitit 2024 në lidhje me Projektin e Kosovës për Sigurinë e Ujit dhe Mbrojtjen e Kanalit (WSCP)

P133829 (Kredia Nr. 5902-XK)

Të dhënat kryesore të Projektit:

Numri i projektit	P133829	Përshkrimi	Datat
Vlera e kredisë	22,000.000.00 €	Data e hyrjes në fuqi	30 Prill 2017
Vlera e kredisë pas ristrukturimit	15,000.000.00 €	Efektiviteti pas ristrukturimit	Origjinali: 31 Prill 2022 Shtyerja 1: 31 Tetor 2023 Shtyerja 2 ¹ - 31 Tetor 2024 Shtyerja 2 ² - 30 Qershori 2025
Vlera e disbursimit e mjeteve te BB-së.	13,132,844.14 € (85.48%)	Data e mbylljes së projektit	30 Qershori 2025

Projekti Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit (WSCPP) është projekt i financuar përmes kredisë nga Qeverinë e Republikës së Kosovës, e cila i është drejtuar Bankës Botërore që të mbështesë implementimin e projektit për rehabilitimin e kanalit kryesor të N.H „Ibër - Lepencit.” Objktivi i Projektit është rikthimi i kapacitetit fillestar të Kanalit Ibër për të përmirësuar menaxhimin e burimeve ujore për shfrytëzuesit e ndryshëm të ujit të kanalit në Kosovën qendrore. Në bazë të kësaj marrëveshjes dhe ristrukturimit të saj, data e përfundimit të projektit është data 30 Qershori 2025.

Projekti Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit, ka 3 komponente apo nën projekte, siç janë:

- Rehabilimi i kanali kryesor të,, Ibër -Lepencit,”
- Mbikëqyrja e punimeve nga kompania e kontrakuar,
- Furnizimi dhe insatlimi i projektit të SKADA-s.

Në realizimin e projektit “Rehabilimi i kanali kryesor të,, Ibër -Lepencit”, punët janë duke u zhvilluar me një standard të lartë dhe me dinamikën e paraparë.

Njësia për Zbatimin e Projektit (PIU), në bashkëpunim të ngushtë me akterët përkatës, kanë ndërmarrë aktivitetet për të përbushur detyrat dhe objektivat e planifikuar të Projektit, të cilat janë përshkruara më poshtë.

Arritjet kritike në periudhën raportuese 2024

Nr. 1 – Punimet dhe pastrimi

Kontraktori ka kryer të gjitha punimet sipas këtij zëri të punimeve.

Nr. 2 – Rehabilitimi i kanalit të hapur

Në fund të majit 2024, Kontraktori ka filluar bypass-in e fundit për këtë tip kanali trapezoid, në segmentin A7.4.4 në Km 45+704.08 deri në Km 46+405.13 me L= 701.05m', dhe ka përfunduar 300m'.

Gjatë Nënëntorit 2024, Kontraktori ka filluar bypass-in anësor për Segmentin A7.4.2 në Km 42+266.03 deri në Km 42+527.60 me L= 261.57m' dhe ka përfunduar gërmimin për bypass-in anësor. Devijimi i plotë i ujit është finalizuar gjatë dhjetorit 2024 dhe fillimi i rehabilitimit të segmentit A7.4.2.

Gjithashtu, gjatë muajit gusht, kontraktori ka instaluar dy stacione të përkohshme pompimi nga betoni armë për 3 pompa, si dhe ka instaluar pompat duke përfshirë HDPE Ø1200mm, në segmentin A4.2 nga Km 29+725.46 deri në Km 31+190.89, L=1,465.43m.

Kontraktuesi dhe punëdhënësi janë pajtuar për ndryshimin e furnizimit me energji nga KEDS-i me gjenerator. Si i tillë, kontraktori do të furnizojë dy gjenerator të cilët pas përfundimit të kontraktorit do t'i transferohen punëdhënësit.

Lloji i gjeneratorit, AON 500PL, me motor Perkins dhe kapacitet 450kVA / 360 janë dorëzuar në 15 nënëntor 2024 dhe i lidhur për anashkalim uji. Mirëpo, për shkak të sulmit terrorist të datës 29 nënëntor 2024, në Aquaduktin-PAK 1.2 në Km 05+054.00 deri në Km 05+126.55, devijimi me anashkalimin e ujit nga pompa pezullohet nga menaxhmenti i ndërmarrjes, derisa të sigurohet rrjedha e ujit në aquaduktin e sulmuar dhe në kanalin kryesor.

Në datën 18 Shkurt 2024, kontraktori ka filluar bypass-in nga kanali anësor në segmentin B10A.15 në Km 47+280.00 deri në Km 47+364.47 dhe ka vazhduar me segmente të tjera për kanalin e tipit drejtkëndor. Deri në fund të raportimit, kontraktori ka përfunduar 100% 6 segmente dretëkëndore dhe rreth 90% të segmenteve të fundit, duke përfunduar 918.85m' nga 1,032.30m' ose 90.15% të segmenteve drejtkëndëshe.

Deri në fund të kësaj periudhe raportuese, Kontraktori ka përfunduar rehabilitimin e 14 segmenteve të Aquadukteve, duke arritur në afersisht 89.07% të progresit për rehabilitimin e aquadukteve, ose duke përfunduar 1,897.09m' nga 2,129.89m'.

Nr. 3 – Bypass i ujit (Bypass me pompa);Më 12 shkurt 2024 ka filluar furnizimi me tubacionet HDPE dhe deri në fund të kësaj periudhe raportuese të gjitha DN 1200mm, PN 6 dhe DN 900mm, PN 6 janë dorëzuar në kantier.

SIGURIA NË PUNË

Mbrojtje mjedisore, shëndetësore dhe sociale gjatë periudhës raportuese, specialisti i mbrojtjeve mjedisore dhe sociale, së bashku me kompaninë mbikëqyrëse, kryen vizita të shumta në terren për të vlerësuar kushtet mjedisore, shëndetësore, të sigurisë dhe sociale të projektit. Vlerësimet dolën në përfundimin se kushtet mjedisore në kantier janë përmirësuar dhe shqetësimet e ngritura paraprake janë adresuar në mënyrë efektive nga kontraktori.

U organizuan seanca trajnimi periodike për punonjësit e rinj, të përshtatura për rolet e tyre specifike. Vëmendje e veçantë ishte një program trajnimi i specializuar për montimin dhe funksionimin e pompave. Projekti mbajti një rekord të fortë sigurie, me zero aksidente të raportuara gjatë periudhës. Për më tepër, nuk ka pasur ankesa të paraqitura nga komiteti i monitorimit, duke reflektuar përputhshmërinë e projektit dhe kënaqësinë e palëve të interesuara.

11. Aktivitetet tjera gjatë vitit 2024


11.1 Performanca Financiare gjatë viteve 2019-2024

Ky raport paraqet një analizë të detajuar të performancës financiare të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Ibër- Lepenc" për periudhën 2019-2024, duke vlerësuar ndryshimet në të hyrat, fitimin neto dhe fitimin para zhvlerësimit. Analiza synon të evidentojë trendet kryesore financiare, faktorët që kanë ndikuar në përmirësimin e bilancit dhe ndikimin e strategjive të menaxhimit në rritjen e qëndrueshme të ndërmarrjes. Gjatë kësaj periudhe, ndërmarrja ka kaluar nga një fazë sfidash financiare në vitet 2019-2021, ku u përball me humbje të konsiderueshme, në një rritje të qëndrueshme duke filluar nga viti 2022. Në vitin 2024 të hyrat kanë arritur nivelin më të lartë historik, ndërsa fitimi neto dhe ai para zhvlerësimit kanë shënuar rritje domethënëse, duke reflektuar një menaxhim më efikas të burimeve dhe optimizim të shpenzimeve operacionale.

Ky raport synon të ofrojë një analizë të qartë dhe të bazuar në të dhëna, duke krahasuar performancën financiare ndër vite dhe duke identifikuar faktorët kryesor që kanë ndikuar në ndryshimet financiare. Gjithashtu, në të përfshihen grafikët dhe tabelat kryesore që vizualizojnë rezultatet financiare të ndërmarrjes duke ndihmuar në kuptimin më të lehtë të progresit të arritur.

Të hyrat dhe analiza e tyre

Gjatë viteve 2019-2024, të hyrat e N.P.H "Ibër- Lepenc" kanë ndjekur një trend të rritjes së vazhdueshme, me një përmirësim të dukshëm nga viti 2021 e tutje.




Në vitin 2024, të hyrat totale arritën në **11,344,019 €**, duke shënuar një rritje të vazhdueshme krahasuar me vitet e mëparshme. Kjo rritje është rezultat i një menaxhimi më efikas të shërbimeve dhe optimizimit të operacioneve financiare.

Analiza grafike:

Sic tregohet në grafikonin më lartë periudha 2021-2024 ka qenë periudha me rritjen më të theksuar të të hyrave, duke reflektoar përmirësimin e operacioneve dhe strategjive të menaxhimit financiar. Pas një rënjeje të lehtë në vitin 2020 të hyrat kanë vijuar me një trend rritës të qëndrueshëm, me një mesatare rritjeje vjetore të konsiderueshme. Kjo tregon se ndërmarrja ka arritur të stabilizojë dhe të rrisë kapacitetet e saj operacionale në një mënyrë të qëndrueshme.

Fitimi para zhvlerësimit

Fitimi para zhvlerësimit ka shënuar një rritje të ndjeshme gjatë periudhës 2019-2024, duke kaluar nga **857,913 €** në vitin 2019 në **6,250,000 €** në vitin 2024. Ky përmirësim i ndjeshëm tregon fujizimin e bazës financiare të ndërmarrjes dhe menaxhimin më efikas të shpenzimeve operacionale.



Analiza grafike:

Sic shihet në grafikonin më lartë, nga viti 2021 ka një rritje të fitimit para zhvlerësimit, duke shënuar një transformim të rëndësishëm financiar të ndërmarrjes. Pika më e rëndësishme e kthesës është viti 2022, ku fitimi para zhvlerësimit shënoi një rritje të ndjeshme mbi 3.3 milionë euro krahasuar me vitin 2021.

Në vitet pasuese, 2023 dhe 2024, trendi rritës është ruajtur, me një rritje më të moderuar, duke arritur një fitim prej **6,250,000 €** në vitin 2024. Kjo stabilizim tregon një përdorim më efikas të burimeve financiare dhe një menaxhim më të mirë të shpenzimeve, duke siguruar një bazë të fortë për qëndrueshmërinë e ardhshme financiare të ndërmarrjes.

Fitimi neto i vitit

Ndërmarrja ka kaluar nga një situatë e vështirë financiare në vitet 2019-2021, me humbje të konsiderueshme në një periudhë fitimi të qëndrueshëm nga viti 2022 e tutje. Në **vitin 2024**, fitimi neto arriti në **1,832,977 €**, një përmirësim i dukshëm krahasuar me vitin 2023.



Analiza grafike: siç tregohet në grafikonin më poshtë, **transformimi finanziar është më i dukshëm pas vitit 2021**, kur ndërmarrja kaloi nga humbjet në një trend të qëndrueshëm të fitimit neto.

Pikat kryesore të analizës:

- **2019-2021:** humbje të mëdha, me kulmin në vitin 2020 (-4,123,323 €), si rezultat i shpenzimeve të larta dhe efikasitetit të ulët operativ.
- **2022:** ndërmarrja arrin të kalojë në një bilanc pozitiv me një fitim modest prej **379,073 €**, si pasojë e strategjive të reja financiare dhe menaxhimit më të mirë të kostove.
- **2023-2024:** fitimi neto rritet ndjeshëm, duke arritur në **1,832,977 €** në 2024², duke reflektoar një stabilizim të fortë të ndërmarrjes dhe optimizim të operacioneve financiare.

Ky përmirësim është rezultat i **strategjive më të mira të menaxhimit të kostove dhe investimeve të duhura**, të cilat kanë çuar në rritjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe zvogëlimin e shpenzimeve operative.

Përfundim


Gjatë periudhës 2019-2024, Ndërmarrja Hidroekonomike "Ibër -Lepenc" ka përjetuar një transformim të rëndësishëm financiar, duke kaluar nga një situatë e vështirë me humbje të mëdha në vitet e para në një rritje të qëndrueshme nga viti 2022 e tutje. Të hyrat dhe fitimi neto kanë arritur nivelet më të larta historike në vitin 2024, duke reflektoar një menaxhim më të mirë dhe optimizim të burimeve.

² Shpenzimet e dëmit nga sulmi terrorist në akueduktin e fshatit Varage, komuna e Zubin Potokut, janë në vlerën e 314,675.4 EUR, të cilat nuk janë përfshirë në fitimin e periudhës 2024, por janë të regjistruara në Pasqyrat Financiare.

11.2 Sulmi Terrorist në Varagë dhe veprimet e ndërmarra për sanimin emergjent dhe përfundimtar të dëmeve

Ndër sfidat që i kemi pasë këtë vit është edhe rasti në fshatin Varagë Zubin Potok , të cilin e kemi tejkaluar me sukses. Më datë 29 nëntor 2024, rreth orës 19:00, në akuaduktin në Varage të tipit AK1 në stacionazhën 5,073.30 ndodhi një sulm terrorist. Si pasojë e këtij akti u dëmtua rëndë pjesa fundore dhe njëra ballinë e akuaduktit duke rrezikuar furnizimin me ujë për të gjithë konsumatorët. Menjëherë pas njoftimit nga zyrtarët tanë dhe Policia e Kosovës, të gjitha ekipet e mirëmbajtjes u mobilizuan në vendngjarje. Si masë emergjente u ndërpren plotësisht rrjedhja e ujit nga diga e Pridvoricës për të parandaluar dëme të mëtejshme dhe për të mundësuar fillimin e punimeve riparuese. Falë intervenimit të shpjetë të ekipeve tona u arrit të implementohet një zgjidhje e përkohshme brenda një kohe rekord. Ekipet instaluan 6 gypa me diametër DN900, duke mundësuar rifillimin e rrjedhjes së ujit për furnizimin e konsumatorëve në orën 02:00 të datës 30 nëntor 2024, vetëm 7 orë pas sulmit. Gjatë gjithë procesit të riparimit, janë ndërmarrë masa të veçanta për të siguruar sasi të mjaftueshme uji për Termocentralin Kosova B, duke parandaluar çdo ndërprerje të mundshme të furnizimit energjetik. Këto masa kanë qenë jetike për të shhangur një krizë të dyfishtë energjetike dhe ujore. Pas implementimit të zgjidhjes së përkohshme, furnizimi u stabilizua në rreth 75% të kapacitetit normal, duke siguruar vazhdimësinë e shërbimit për konsumatorët kryq pavarësisht kushteve të vështira. Në fillim të muajit dhjetor, u ndërmorën punime intensive për përmirësimin e situatës. Një zgjidhje e dytë teknike me kontinjer u zbatua me sukses, duke arritur stabilizimin e nivelit të ujit në kanal dhe ruajtur kapacitet normale të furnizimit. Pas miratimit të projektit për sanimin e dëmit nga Bordi në bashkëpunim me projektin WSCPP dhe kontraktorin e angazhuar, filloj ndërtimi i një bajpasi për të mundësuar rindërtimin e segmenteve të dëmtuara të akuaduktit.

Falë punës intensive të kontraktorit, u arrit që në afat rekord prej vetëm një muaji të përfundohet rindërtimi i plotë i akuaduktit të dëmtuar. Rrjedhja e ujit u rivendos plotësisht nëpërmjet akuaduktit, duke kthyer sistemin në kapacitetin e tij të plotë operativ. Ky incident tregoi aftësinë e lartë reaguese të ndërrmarrjës dhe partnerëve tanë në situata emergjente. Pavarësisht natyrës së rëndë të dëmtimit dhe sfidave të paraqitura, ekipet e angazhuara demonstruan profesionalizëm dhe efikasitet të jashtëzakonshëm, duke minimizuar ndikimin e këtij akti terrorist në furnizimin me ujë për konsumatorët dhe duke rivendosur funksionalitetin e plotë të sistemit brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore. Ndërrmarja mbetet e përkushtuar në ruajtjen dhe sigurimin e infrastrukturës së ujit si një aset kritik, ku do të vazhdojë të përmirësojë kapacitetet e reagimit emergjent dhe sistemet e sigurisë për të parandaluar dhe menaxhuar incidente të ngjashme në të ardhmen.





11.3 Integrimi në bursën Alpex

Platforma Alpex ka si qëllim kryesor ofrimin e mundësisë për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike përmes mekanizmave të tregut të hapur, ku ndërmarrjet si „Iber-Lepenc” mund të kontribuojnë dhe përfitojnë nga tregu i energjisë elektrike.

Alpex është një platformë e bursës për tregtinë e energjisë elektrike në rajon, ku blerësit dhe shitësit mund të ofrojnë dhe blejnë energji në kushte të rregulluara ligjore dhe me transparencë të plotë. Alpex ofron mundësi për:

- **Blerje dhe shitje të energjisë elektrike:** platforma mundëson blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për periudha të ndryshme kohore dhe në kushte fleksibile.
- **Sigurimin e çmimeve të tregut:** çmimet e energjisë përcaktohen në bazë të ofertave dhe kërkesës, duke reflektuar realitetin e tregut.
- **Rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e konsumatorëve:** tregu është i hapur dhe i mbikëqyrur duke garantuar që të dy palët të kenë besim në transaksionet e tyre.

Integrimi në platformën **Alpex** ka sjellë disa përfitime për ndërmarrje, përfshirë:

- **Rritje të efikasitetit operativ dhe të prodhimit:** mundësia për të shitur energji në tregun e hapur ka ofruar mundësi për optimizim të prodhimit dhe përfitime ekonomike më të mëdha, ku në dallim me vitin e 2023 që për të arritur shitjen e afér 7.8 milion € është dashur të prodhohen afér 165,000.00 MWh ndërsa në vitin 2024 me rreth 62,000.00 MWh të ardhurat nga shitja në bursen **Alpex** kanë arritur mbi 8.4 milion €.
- **Diversifikimi i të ardhurave:** pjesëmarrja në bursë ka mundësuar që „**Iber-Lepenci**” që të diversifikojë burimet e të ardhurave duke treguar energji në mënyrë më fleksibile.
- **Rritja e transparencës dhe kredibilitetit:** pjesëmarrësit në platformë mund të monitorojnë aktivitetet e tregtisë dhe të kenë besim më të madh në transaksionet e kryera.

Integrimi i ndërmarrjes në platformën e shitjes së energjisë **Alpex** është një hap i rëndësishëm për rritjen e eficiencës dhe konkurencës në tregun e energjisë në Kosovë. Ky proces mund të sjellë përfitime të shumta, si për ndërmarrjen ashtu dhe për konsumatorët e energjisë, duke siguruar energji më të qëndrueshme dhe me çmime më të arsyeshme.

11.4 Vizitat dhe bashkpunimet gjatë vitit 2024

Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve tona gjatë këtijë viti 2024 duhet të veçojmë :

- Vizitën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe Ministres së Ekonomisë znj. Artane Rizvanollitë ndërmarrjes hidroekonomike N.P.H "Iber- Lepenc" Sh.A. janë mirëpritur nga kryeshefi , Bordi i Drejtorëve dhe menaxhmenti i ndërmarrjes. Në fillim të takimit Kryeministri i Republikës së Kosovës z. Kurti ka falenderuar stafin e ndërmarrjes për sukseset e arritura në vitet e fundit, e në veçanti për intervenimin dhe rifunksionalizimin e shpejtë të kanalit kryesor pas sulmit terrorist në Varagë të Zubin Potokut. Gjatë takimit janë diskutuar sukseset dhe sfidat e ndërmarrjes N.P.H "Iber -Lepenc" Sh.A Me mirënjojje të thellë është falenderuar Kryeministri i Republikës së Kosovës z.Albin Kurti për vizitën, marrë parasysh se është hera e parë që një kryeministër viziton N.P.H "Iber -Lepenc" Sh.A. U bisedua për sulmin terrorist të 29 Nëntorit në kanal, ku falë angazhimit, gatishmërisë, vullnetit dhe reagimit të shpejtë të punëtorëve të ndërmarrjes dhe akterëve tjera të përfshirë, është arritur që termocentralet të mos ndalen për asnjë moment . Furnizimi i qytetarëve me ujë ishte relativisht i mirë përgjatë ditëve të para dhe i plotë përgjatë ditëve në vijim.



- **Vizita e Ministres Rizvanollit në Digen e Ujmani-it**

Me datë 13.02.2024 së bashku me Ministren e Ministrisë së Ekonomisë në Republikën e Kosovës vizituam digën e liqenit të Ujëmanit. Gjatë kësaj vizite u diskutua mbi performancën e mirë të ndërmarrjes, sigurinë e digës dhe mundësitë për investime në hidrocentral dhe përgjatë kanalit. Ndërmarrja N.H. „ Ibër-Lepenc” Sh.A që bënë menaxhimin e kësajë dige ka vendosur pajisjet për matjen e lëvizjeve seizmike dhe sigurinë e digës, janë vendosur senzorët që bëjnë matjen e niveleve të ujit edhe nga dhoma e kontrollit në Shkabaj. Niveli i rrjedhjeve në trupin e digës dhe stabiliteti i digës aktualisht kontrollohen nga galeria e cila gjendet në 90 metra largësi.





Këtë vit duhet përmendur faktin që me angzhimin maksimal të Qeverisë së Kosovës dhe me punën tonë në vazhdimësi si ndërmarrje, kemi arritur që për herë të parë në pjesën e territorit në Ujman të vemosim sinjalizimet në gjuhën shqipe dhe flamujt e shtetit tonë Kosovës .



Nënshkrimi i Marrveshjeve të Bashkëpunimit me komunat për subvencionimin e ujites për bujqit në Komunat e Mitrovicës, Prishtinës, Vushtrrisë dhe Obiliqit.

Në vazhdim këto aktivitete dëshmohen me fotot :



Nënshkruhet Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet NPH "Ibër -Lepenc" Sh.A dhe Fakultetit të Ndërtimtarisë – Universiteti i Prishtinës. Bazuar në interesat e përbashkëta është arritur një marrëveshje në mes të këtyre dy institucioneve me qëllim të avancimit dhe ngritjes së arritjeve profesionale në arsimin e lartë, shkencë, bashkëpunimin arsimor dhe akademik ndërmjet dy institucioneve, duke hapur mundësi të reja bashkëpunimi për studentët, stafin akademik dhe atij administrativ. NPH "Ibër - Lepenc" dhe Fakulteti i Ndërtimtarisë do të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit profesional të studentëve, aktivitetave të përbashkëta në realizimin e nevojave ndërinstitucionale, projekte të përbashkëta në lëmitë e ujit, konstruksioneve ndërtimore, gjeodezisë dhe mjedisit. Fakulteti do të nxjerr vendim për angazhimin e studentëve dhe profesorëve, të cilët do të rekrutohen në zyret e ndërmarrjes, për realizimin e punës së praktikës profesionale si dhe në raste kur nevojiten studimet e caktuara në fushën e inxhinierisë ndërtimore. Marrëveshja u nënshkrua nga Kryeshefi i N.P.H "Ibër - Lepenc" Sh.A, z. Faruk Mujka dhe Dekanit të Fakultetit të Ndërtimtarisë, z. Florim Grajçevci.



Mes takimeve që i kemi pas këtë vit është mirë të veçohet vizita nga Ambasadori i Republikës së Francës në Kosovë z. Olivier Guerot, ku gjatë këtij takimi u nënshkruan Marrëveshje Partneriteti për të menaxhuar përdorimin e ujit dhe për të ruajtur këtë burim. Në nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje ishin të pranishëm edhe kryesuesi i Bordit të Ndërmarrjes N.P.H "Iber- Lepenc" Sh.A dhe anëtarët e tjerë të Bordit të drejtorëve . SCP me më shumë se 60 vjet ekspertizë në Provence në menaxhimin e ujit dhe shpërndarjen e ujit të papërpunuar, do t'a mbështesë ndërmarrjen hidroekonomike "Iber -Lepenc" Sh.A., rrëth modernizimit të infrastrukturës dhe ristrukturimit të strategjisë së ndërmarrjes. Vizioni i përbashkët i ndërmarrjes dhe puna e [SCP – Société du Canal de Provence](#) që nga viti 2000 në Kosovë, janë baza e këtij partneriteti të mbështetur nga Ambasada e Francës në Prishtinë.



Impakti social

Ndërmarrja jonë ka shprehur vullnetin dhe gatishmërin për dhurimin e paisjeve të TIK. Duke e ndjerë si përgjegjësi sociale dhe me dëshirën e mirë të mbështetjes së komuninetit, N.P.H "Ibër-Lepenc" Sh.A. ka ndërmarrë një iniciativë të rëndësishme për të dhuruar pajisje të teknologjisë (TIK) për **SHFMU "31 Marsi"** në fshatin Guri i Kuq, Komuna e Rahovecit. Ky vendim është marrë pas parashtrimit të një kërkese nga shkolla për mungesën e kompjuterëve. Duke u bazuar në legjislacionin në fuqi dhe rekomandimet e Komisionit për Vlerësimin e Pasurisë jo Financiare të ndërmarrjes është vendosur që këto pajisje të përdoren si donacion. Pajisjet e dhuruara janë ato që N.P.H "Ibër-Lepenc" Sh.A. i ka hequr nga përdorimi, por që ende mund të shërbejnë për mësim praktik nga nxënësit duke u dhënë një funksion të ri në mbështetje ndaj një arsimimi më cilësor.



Në hollin e Fakultetit të Shkencave Teknike po zhvillohet konferenca "Second International Student Conference of Civil Engineering - (ISCCE) 2024" e organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Për tre ditë me radhë, në datat 25, 26 dhe 27 Prill 2024, do të mblidhen të gjithë kontribuesit dhe palët e interesuara të shkencave të Inxhinierisë së Ndërtimit, për të formësuar zhvillimin akademik të studentëve dhe profesionistëve të ardhshëm.


Në mbështetje të aktiviteteve për studentët, ALB-Architect, përmes Bordit Industrial të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit përgëzon gjithë punën e bërë nga studentët, stafi akademik dhe administrativ i FIN duke uruar që konferenca të sjellë frymë të re në fushën e Inxhinierisë së Ndërtimit në rajon.

Në këtë konferenë Ibër Lepenc ishte sponsor dhe pjesëmarrës.



Ndërmarrja „Ibër -Lepenc ” në vazhdimësi është në përkrahje të arsimit dhe zhvillimit akademik dhe profesional . Duke shprehur vullnetin e mirë me mjete financiare është përkrahur puna disa mujore e librit me titull „ **Pionerët e Inxhinierisë Ndërtimore** ” një vepër prej 60 faqesh e cila është dedikuar kujtimit të profesorëve të ndjerë që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në arsimimin e brezave të rindje në fushën e ndërtimitarisë . Ky botim është shpërndarë falas për studentët e Fakultetit të ndërtimitarisë , Bibliotekën Kombëtare dhe institucionet tjera arsimore . Kostoja e këtijë libri ka qenë 4 euro për një libër, kurse ne kemi kontribuar me 1 mijë euro. Shpresoj që ky libër do të kontribuoj sado pak në informimin e gjeneratave në vazhdim që puna dhe kontributi i profesorëve të mos mbetet në harresë .

Inxh. Jeton CANHASI



PËRKUJTIM (IN MEMORIAM)

PIONERËT E INXHINIERISË NDËRTIMORE